

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		12/09/2018	
Nj. Org	Numër	Shtojca	Vendi
01	060	55015	

**PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSB)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)**

Komuna / Opština: <u>Drenas</u> Data / Datum: <u>11/09/2018</u>
Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 4
<u>Takim i rregullt</u> / Redovni sastanak ☒ Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak ☐
Numri i anëtarëve të KKSB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: <u>12</u>
A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSB-së? Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?
Po / Da ☐ Jo / Ne ☐ Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☒
A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSB-së? Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?
Po / Da ☒ <i>KFOR-LMT K9, UNMIK</i> Jo / Ne ☐
<i>Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju</i>
A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari? Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?
Po / Da ☒ Jo / Ne ☐
Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:
1. Procesverbali i mbledhjes së kaluar, mbajtur më 01.06.2018. 2. Prezantimi i raportit nga DKA dhe Stacioni Policor në Drenas, rreth parandalimit të dukurive negative për vitin akademik 2017/2018. 3. Emërtimi i rrugëve dhe sistemi i adresave.

4. Të ndryshme.

Në pikën e katërt (4) të rendit të ditës tek të ndryshmet, u diskutuan këto pika të rendit të ditës, propozuar nga Arben Nika:

1. Aksioni ta pastrojmë Kosovën,
2. Bazeni te pishat në Kamenicë;
3. Shaktat (pusetat) e pambuluar në Poklek të Ri,
4. Vendosja e shenjave sinjalizuese nga Operatorët Ekonomik gjatë punë.

Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:

Konkluzionet / Zaključci:

1. Pika e parë e rendit të ditës u miratua unanimisht.
2. Në pikën e dytë u prezantua raporti rreth parandalimit të dukurive negative për vitin akademik 2017/2018, nga përfaqësuesi i DKA-së, Hazir Elshani dhe Komandanti i Stacionit Policor në Drenas, Bashkim Bytyqi.
3. Ndërsa në pikën e tretë, emërtimi i rrugëve dhe sistemi i adresave raportoi zyrtari i Urbanizmit, Besart Bajrami, rreth sistemit të unifikimit të vendbanimeve, lagjeve dhe banesave.
4. Tek të ndryshmet, u diskutuan këto pika të rendit të ditës:
 - Aksioni ta pastrojmë Kosovën, Drejtoresha Lumniye Krap i njoftoi të pranishmit rreth këtij aktiviteti i cili do të filloj me 15 shtator 2018, ajo tha se ne si komunë i kemi marr masat, e kemi formuar task forcën me të gjithë akterët në mënyrë që ta bëjmë një pastrim gjeneral të amvisërisë dhe me 17 shtator 2018 largohen të gjitha deponitë e egra në territorin e komunës së Drenasit.
 - Bazeni te pishat në Kamenicë afër Gllobarit, e propozuar nga Arben Nika për rrezikun që shkakton, bazeni është i hapur, ska masa të sigurisë dhe është i thellë. Fëmijët shkojnë shpesh andej sidomos barinjët, disa e përdorin edhe për larje (pastrim). Pas diskutimeve u vendos të merren masa për mbulimin apo mbylljen e atij bazeni.
 - Shaktat (pusetat) e pa mbuluar në Poklek të Ri, pas punës së mirë që është bërë në këtë fshat në kanalizime, Oparatori Ekonomik i ka lane 5 shakta (puseta) të hapur, pa kapakë e aty kanë rënë delet dhe kanë mbetur, janë të rrezikshëm sidomos për fëmijë. U vendos të merren masa për mbulimin e atyre shaktave (pusetave).
 - Vendosja e shenjave sinjalizuese nga Operatorët Ekonomik gjatë punës, sepse nuk po vendosin asnjë


shenjë që janë duke kryer punime.

Të gjitha këto pika të rendit të ditës u diskutuan dhe u dhanë disa rekomandime e konkluzione.

Pjesëmarrësit patën rastin të elaborojnë edhe çështje tjera me Kryetarin e Komunës dhe zyrtarë përgjegjës të Sektoreve.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori e KKSB-së:


Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Rinore Zymeri
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime i potpis)



Procesverbali aprovohet nga Kryetari:

Izveštaj odobrava Gradonačelnik: Ramiz Lladrović

nënshkrimi / potpis



Data e aprovimit / Datum odobranja: 11/09/2018

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.